



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 dhe nenit 5 të Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 të datës 29.05.2020, Kryetari i Komunes nxjerr:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSIVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË BURSË PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK-SHKOLLOR 2020/2021

I. Me këtë Vendim ndahen edhe 40 (katërdhjetë) bursa për studentë të Komunës së Lipjanit për vitin akademik – shkollor 2020/2021 shuma financiare për një burse do të jetë 500 € (pesëqind euro).

II.OBLIGOHET, Drejtorati për Arsim pas pranimit të këtij Vendimi sipas kriterëve të Thirrjen Publike për aplikim publik Nr.4-670-51516 të datës 20.10.2020 të shpallur nga Drejtorati i Arsimit, konform kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 të datës 29.05.2020 të ndahen edhe 40 (katërdhjetë) bursa shtesë me nga 500€ (pesëqind euro).

III. Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kultur, Rini dhe Sport në xhirollogaritë personale të secilit përfitues të zgjedhur.

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë

1Nr. 670-56904
Lipjan, më 18.11.2020

KRYETARI KOMUNËS
Imri Ahmeti

